



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.34, datë 20.11.2024

PËR

**MIRATIMIN E PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE PËR MËNYRËN E PËRFUNDIMIT
TË PUNIMEVE, PRISHJEN APO KONFISKIMIN E NDËRTIMIT PËR PUNIMET E
FILLUARA PREJ MË SHUMË SE DHJETË VJETËSH DHE ENDE TË
PAPËRFUNDUARA**

Në mbështetje të neneve pikës 6 të nenit 40 të Ligjit Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 725, datë 02.09.2015 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Territorit, me propozimin e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit,

VENDOSI:

1. Për lejet e ndërtimit të lëshuara nga autoritetet e zhvillimit të territorit, të cilave u ka përfunduar afati i vlefshmërisë dhe punimet sipas të cilave kanë filluar prej më shumë se dhjetë vjetësh dhe ende nuk kanë përfunduar, subjektet zhvilluese mund të aplikojnë për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit dhe autoritetet e zhvillimit mund të shqyrtojnë kërkesat në sistemin elektronik të lejeve të ndërtimit, sipas përcaktimeve në vijim:
 - 1.1 Për lejet e ndërtimit të lëshuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, kur kondicionet urbane të objektit të miratuar me lejen e ndërtimit, janë në përputhje me parashikimet e Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) në fuqi, njësitë vetëqeverisjes vendore mund të shqyrtojnë kërkesat për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit;
 - 1.2 Për lejet e ndërtimit të lëshuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore brenda brezit bregdetar, kur kondicionet urbane të objektit të miratuar me lejen e ndërtimit, janë në përputhje me parashikimet e Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) në fuqi, njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shqyrtojnë kërkesat për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit, vetëm pas marrjes së konfirmimit për projektin nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e sekretariatit të KKTU-së;



13. Për lejet e ndërtimit të lëshuara nga njësitë e qeverisjes vendore, kur kondicionet urbane të objektit të miratuar me lejen e ndërtimit, nuk janë në përputhje me parashikimet e Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) në fuqi, KKTU mund të shqyrtojë kërkesat për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit.
2. Subjektet zhvilluese apo subjektet që kanë përfituar të drejtat e zhvillimit mund të aplikojnë për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit dhe autoritetet e zhvillimit mund të shqyrtojnë kërkesat në sistemin elektronik të lejeve të ndërtimit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
 3. Dokumentet, që duhet të paraqesë subjekti zhvillues apo subjekti që ka përfituar të drejtat e zhvillimit në sistemin e-leje, për t'u pajisur me shtyrjen e afatit sipas përcaktimeve të këtij vendimi janë:
 - a) prokura ose autorizimi, në emër të personit fizik apo juridik, në rast se kërkesa paraqitet nga një përfaqësues i pronarit ose zhvilluesit;
 - b) relacioni ku të shpjegohen arsyet e vonesës dhe mënyra e përfundimit të punimeve;
 - c) projekti i plotë arkitektonik sipas Lejes së Ndërtimit të lëshuar nga autoriteti përgjegjës;
 - d) deklaratë nga inxhinieri konstruktor mbi qendrueshmërinë e objektit;
 - e) pagesa e gjobës sipas nenit 52 të Ligjit Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.
 4. Në rast se subjektet zhvilluese apo subjektet që kanë përfituar të drejtat e zhvillimit nuk aplikojnë për shtyrje të afatit sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij vendimi, do të zbatohen rregullat për konfiskimin sipas parashikimeve të VKM-së Nr. 589, datë 07.09.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”.
 5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI
EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 12/12/2024